

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me zyrtaren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të pandehues F.I. nga ..., për shkak të veprës penale rrezikim I trafikut public nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1930/17 të datës 26.10.2017, të cilin e përfaqësonte prokurori Shefik Memeti Pas mbajtjes në seancën fillestare gjyqësore, publike dhe orale lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajsisë dhe dënimit në Prokurori të datës 13.02.2018, me datë 13.02.2018 publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara F.I. nga i ati H., dhe nëna Sh. e lindur S., i lindur me datë ..., e lindur në ... ku edhe jeton me vendbanim në ..., Rruga " ..." nr...., e martuar, nënë e dy fëmijeve, e ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R E

S E P S E

-më datë 15.10.2017 rreth orës 14.50 minuta, në ... në parkingun e ndërtesave në rrugën " ..." duke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës " ..." me ngjyrë të bardhë dhe targa të regjistrimit ..., ka shkelur paragrafin 1 të nenin 52 ë Ligjit nr.05/L-088, për rregullat e trafikut rrugor dhe ka rrezikuar jetën e njerëzve në atë mënyrë që nuk iu është përmbajtur dispozitave të lartpërmendur të ligjit në fjalë që kanë të bëjnë me obligimin e shoferit sipas të cilit "Nëse shoferi i mjetit synon të lëvizë prapa me mjetin e tij, këtë mund ta bëjë në një pjesë të shkurtër të rrugës vetëm nëse nuk i pengon ose nuk i rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në trafik, lehtë ka menduar se edhe përkundër këtyre lëshimeve nuk do të shkaktoj pasojë të ndaluar, ashtu që duke lëvizur mbrapa me automjetin e saj të lartpërmendur nuk i respekton rregullat e lart përmendura të komunikacionit dhe për pasojë me kohë nuk ka mundur ta ndaloj automjetin e saj dhe me pjesën e pasme të anës së djathtë godet këmbësoren – tani të dëmtuarën A.C. e cila në momentin kritik ishte duke ecur në këmbë në parkingun e lartpërmendur, me ç'rast të njejtës i kishte shkaktuar lëndime të lehta trupore në formë të

ndrydhjeve të indeve të buta të shpinës, krahut dhe pjesëve tjera në anën e djathtë të trupit, me pasoja të përkohëshme për shëndetin.

-me çka ka kryer veprën penale : rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur, si dhe në nenet 4,7,17,23,41,42,43 ,46, 73, të KPRK-së si dhe te neneve 365 e 451 të KPPRK-ës atij i shqipton

DENIM ME GJOBË

I. Të akuzuarës F.I. i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 250 (dyqindpesdhjetë)€, të cilën gjobë do t'a paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë, do t'i zëvendësohet me dënim burgu.

II. E akuzuara obligohet që dënimin e shqiptuar me gjobë ta paguaj në dy këste mujore, ashtu që këstin e parë prej 100€ do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së preprë, ndërsa këstin tjetër në shumë prej 150€ ta paguaj në muajin vijues dhe atë pas një muaji nga dita kur është bërë i pagesa e këstit të parë.

III. Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, obligohet e akuzuara që në emër të taksave për kompensimin e viktimave, të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) Eurove.

IV. E dëmtuara për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1930/17 të datës 26.10.2017, kundër të akuzuarës F.I. nga ..., për shkak të veprës penale nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Asnjëra palë nuk e kundërshtoi gjyqtarin e vetëm gjykues, nuk pati asnjë vërejtje ndaj të njëjtit.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë si dhe të sanksionit penal i është paraqitur gjyqtarit të vetëm gjykues konform nenit 233 të KPPRK-së më datën 13.02.2018, e cila si e tërë është edhe pjesë përbërëse e kësaj lënde penale.

Për veprën penale nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vite.

Përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Gjilan, prokurori i shtetit Shefik Mehmeti, e ka njoftuar gjyqtarin e vetëm gjykues për dhënien e pëlqimit me shkrim nga ana e kryeprokurorit dhe për lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal, duke hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve të propozuar si dhe të shtjellimit të provave të tjera materiale.

Mbrojtësi i të akuzuarës F.I, avokati me autorizim G.S. nga ..., e ka njoftuar gjyqtarin e vetëm gjykues për marrëveshjen në fjalë të lidhur me përfaqësuesin e akuzës në prezencën e të akuzuarës, duke hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe të shtjellimit të provave tjera, po ashtu duke kërkuar që dënimi për të akuzuarën të jetë dënim me gjobë e që të njëjtin nuk e kundërshtoi as prokurori, e as gjyqtari i vetëm gjykues e i cili këtë edhe e aprovoi.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal për të akuzuarën, i përmbajnë të gjitha kushtet, duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe sanksionimit penal, e bërë në mënyrë vullnetare, duke deklaruar edhe për arsyet e pranimit të fajësisë si dhe të sanksionit penal.

Gjykata ka gjetur se palët procedurale marrëveshjet në fjalë i kanë bërë konform dispozitës ligjore të nenit 233 të KPPRK-së.

Gjykata është e bindur se e akuzuara e ka kryer veprën penale nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë diskualifikim i cekur nga neni 233 të KPPRK-së.

Pasi që palët procedurale, prokurori i shtetit, e akuzuara dhe mbrojtësi i saj që ishte prezent në seancën dëgjimore, kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal, gjykata atë e mori dhe e pranoi pa kurrfarë hezitimi si të arritur me vullnet nga palët procedurale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarës në fjalë , gjyqtari i vetëm gjykues mori për bazë marrëveshjen mbi pranimin vullnetar të fajësisë dhe të sanksionit penal ndaj të akuzuarës të lartcekur si dhe rrethanat tjera lehtësuese si sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin për atë çka kishte bërë , premtimin se një gjë të tillë atë kurrë nuk do ta përsërisë, është, hera e parë që ndeshet me ligjin, e si rrethana rënduese mori pasojat e shkaktuara të dëmtuarës.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar me gjobë është në harmoni me peshën e veprës penale, kështu që me këtë dënim do të mundet të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me neni 41 të KPRK-së.

Përfaqësuesi i aktakuzës, i dëmtuari dhe mbrojtësi i tij deklaruan se heqin dorë nga ankesa.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 451 të KPPRK-së.

Andaj,nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti I Përgjittshëm
P.nr. 1144 të datës 13.02.2018

Zyrtarja Ligjore
Florentina Ademi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ramiz Azizi

KËSHILLA JURIDIKE *Palët procedurale kanë hequr dorë nga ankesa e këtij aktgjykimi, andaj i njëjti nuk mundë të ankimohet dhe bëhet menjëherë I formës së prerë.*